

20221532068

Në bazë të nenit 25 paragrafi (1) dhe (3) dhe (47), paragrafi (1), pika 20) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

**VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË KARTËMONEDHAVE ME VLERË
NOMINALE 2000 DENARË**

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim kartëmonedhat me vlerë nominale 2000 denarë me shenjë të shtypjes "maj 2022" (maj 2022) dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetim, vlerë nominale dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave 200 dhe 2000 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 74/15) dhe Vendimin për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 2000 denarë me karakteristika të ndryshuara "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 49/21 dhe 83/22), duke filluar nga 1 gushti 2022.

2. Me lëshimin në qarkullim të kartëmonedhave nga pika 1) e këtij Vendimi, në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në qarkullim do të mbeten edhe kartëmonedhat me vlerë nominale 2000 denarë, sipas Vendimit për emetim, vlerë nominale dhe karakteristikat themelore të kartëmonedhave 200 dhe 2000 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/15).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V nr.02-15/X-7/2022
30 qershor 2022
Shkup

Guvernatore
dhe kryesuese
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
dr. **Anita Angellovska-Bezhoska**, d.v.